

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

STATUTI

TIRANË, 2008

TIRANË, 2008

K R E U I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT) është krijuar në vitin 1951, si Institut i Lartë Politeknik dhe në vitin 1957 përfshihet në Universitetin e Tiranës. Me VKM Nr. 215, datë 15.07.1991 “Për riorganizimin e Universitetit të Tiranës” krijohet Universiteti Politeknik, duke u shkëputur nga Universiteti i Tiranës të gjitha Fakultetet me formim inxhinierik, ndërsa me VKM Nr. 560, datë 22.08.2007 “Për bashkimin e disa instituteve dhe njësive kërkimore, organizimin e tyre në Institutin Energjisë, Ujit dhe Mjedisit, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës dhe funksionimin e Institutit në periudhën kalimtare” dhe VKM Nr. 561, datë 22.08.2007 “Për bashkimin e disa instituteve dhe njësive kërkimore, organizimin e tyre në Institutin e Gjeoshkencave, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës dhe funksionimin e Institutit në periudhën kalimtare”, Universitetit Politeknik i bashkëngjiten edhe këto dy Institute.

Neni 2

Statuti i UPT është hartuar duke u bazuar në Ligjin Nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe në gjithë legjislacionin tjetër në fuqi. Ai e shtrin veprimin e vet mbi të gjitha njësitë përbërëse organizative të këtij Universiteti.

Neni 3

Misioni i UPT është:

- a) të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve si edhe të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj;
- b) të ofrojë mundësi për të përfituar nga arsimi i lartë gjatë gjithë jetës;
- c) të ndihmojë zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal;
- ç) të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e të rinjve për një shoqëri të tillë.

Neni 4

Arsimi i lartë në UPT zhvillohet në përputhje me parimet dhe Standardet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (HEAL), duke reflektuar parimet dhe objektivat e procesit të Bolonjës.

Neni 5

UPT gëzon liri akademike në mësimdhënie, në kërkim shkencor dhe në krijim, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Liria akademike qëndron në respektimin e shumëllojshmërisë të opinioneve, të ideve e metodave dhe në garantimin e zhvillimit të lirë, kritik e krijues të mësimdhënies e të kërkimit shkencor si dhe të shërbimeve në përputhje me standardet evropiane.

Neni 6

UPT është institucion autonom. Në kuadrin e kësaj autonomie UPT i njihet e drejta e:

- a. vetëqeverisjes për të organizuar strukturat e brendshme dhe veprimtaritë e ndryshme nëpërmjet këtij statuti dhe rregulloreve, të hartuara në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi;
- b. hartimit dhe zhvillimit të pavarur të programeve të studimit dhe të projekteve të kërkimit;
- c. përcaktimit të kriterëve të veçanta të pranimit të studentëve në programet e studimeve;
- d. mbledhjes së fondeve dhe përfitimit të mjeteve materiale, sipas rregullave në fuqi;
- e. realizimit të marrëveshjeve të pavarura me Qeverinë ose organizma të tjerë për trajnime, kualifikime ose për projekte kërkimore;
- f. realizimit të marrëveshjeve me institucione, shoqëri biznesi ose organizata të tjera, vendase ose të huaja, publike ose private;
- g. administrimit të fondeve publike e të ardhura të tjera, që disponon sipas mënyrës së përshkruar në ligj;
- h. aktivitetit botues në përputhje me nevojat e procesit mësimor e të kërkimit shkencor;
- i. përzgjedhjes të personelit të tij.

Neni 7

Të gjitha mjediset ku e ushtron veprimtarinë e vet dhe që shteti ia ka lënë në administrim UPT, gëzojnë me ligj paprekshmërinë. Nuk lejohet ndërhyrja në mjediset universitare e personave fizikë apo juridikë privatë e shtetërorë , e pushtetit qendror e lokal, si dhe ajo e organeve të rendit publik pa lejen apo kërkesën e rektorit ose të personit të autorizuar prej tij.

Cenimi i kësaj paprekshmërie përbën akt precedent, ndaj UPT i lind e drejta e denoncimit të shkeljes, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Në rastin e kryerjes së një krimi flagrant ose kundër jetës dhe e një fatkeqësie natyrore, të cilat konsiderohen si raste përjashtimore të kësaj paprekshmërie, organet e rendit publik mund të ndërhyjnë edhe pa lejen e rektorit.

KREU 2

ORGANIZIMI I UNIVERSITETIT POLITEKNIK

Neni 8

Universiteti Politeknik i Tiranës – Institucion i Arsimit të Lartë

1. UPT, si një Institucion i Arsimit të Lartë (IAL) publik, funksionon në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 9741, dt. 21.05.2007, “Për arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe me dispozitat përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë
2. UPT është person juridik, në përputhje me legjislacionin në fuqi, i cili njeh të drejtat dhe detyrimet e tij.
3. UPT ofron arsimim të lartë në Republikën e Shqipërisë dhe programe të akredituara të studimeve të larta, në përputhje me kërkesat e zhvillimit afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë të vendit.
4. UPT funksionon dhe akreditohet në përputhje me Ligjin Nr.9741, dt. 21.05.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve ligjore e nënligjore në zbatim të tij.

Neni 9

Arsimimi në UPT

1. UPT, në përputhje me Ligjin Nr.9741, dt. 21.05.2007, “Për arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 24, për të realizuar aktivitetet sipas Nenit 2 të këtij Statuti, përdor këto forma studimi:
 - a. Studime me kohë të plotë, për të tre ciklet, për të dy nivelet Master si dhe kurse të tjera kualifikimi dhe specializimi.
 - b. Studime me kohë të pjesshme për Master të niveli të parë, Master të nivelit të dytë dhe Ciklin e Tretë të studimeve.
2. Studime në formën e edukimit në distancë për Ciklin e Parë.
3. Arsimimi në UPT organizohet i koordinuar me kërkesat e zhvillimit kombëtar, në bashkërendim me Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës.
4. UPT siguron arsimim të bazuar në njohuri shkencore, kërkim dhe teknologji bashkëkohore.
5. UPT përgatit specialistë dhe shkencëtarë të rinj përmes tre ciklesh të arsimimit universitar. Nëpërmjet programeve të tij mësimore, siguron arsimim të vazhduar, kualifikime me kohëzgjatje të ndryshme, si dhe specializime në fusha dhe drejtime të kërkuara nga zhvillimi i vendit.
6. UPT ofron programe të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve, ECTS. Programet e studimeve hartohen nga njësitë përbërëse të UPT dhe miratohen nga Senati i tij.

Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës

7. UPT shpall publikisht titujt e diplomave, kurset e studimit dhe programet e tyre, para aplikimit të kandidatëve për pranim në të.

Neni 10

Kërkimi shkencor në UPT

1. UPT realizon kërkim shkencor bazë dhe të aplikuar me anë të njësive përbërëse organizative, kryesore, bazë dhe ndihmëse.
2. UPT ofron shërbime për të tretët, në përputhje me misionin dhe me statusin juridik të tij.

Neni 11

Arsimimi dhe kërkimi me interes të përbashkët

1. UPT mund të kryejë veprimtari arsimimi me interes të përbashkët në bashkëpunim me institucione të tjera akademike, institucione kërkimore-shkencore, kulturore dhe ekonomike, publike ose private.
2. UPT mund të kryejë veprimtari kërkimore-shkencore të niveleve të ndryshme dhe me interes të përbashkët në bashkëpunim me institucione të tjera si universitete, institucione kërkimore-shkencore, kulturore dhe ekonomike, publike ose private.
3. Për veprimtaritë sipas Nenit 11, pikat 1 dhe 2, që emërtohen si bashkëpunime të UPT-së në fushën e arsimimit dhe kërkimit shkencor me interes të përbashkët, UPT mund të propozojë ngritjen dhe të marrë pjesë në Qendra Ndëruniversitare.

Neni 12

Njësiti përbërëse të Universitetit Politeknik të Tiranës

1. UPT, bazuar në legjislacionin ekzistues, me anë të këtij Statuti si dhe të Rregulloreve që hartohen në përputhje me të, përcakton organizimin e brendshëm të tij.
2. Brenda UPT funksionojnë këto njësi përbërëse:
 - *Njësi kryesore* : është fakulteti dhe instituti i kërkimit dhe zhvillimit.
 - *Njësi bazë* : është departamenti dhe qendra e kërkimit.
 - *Njësi ndihmëse*: është laborator, stacioni eksperimental, biblioteka, si dhe organizime të tjera që realizojnë studime, projekte dhe shërbime.

Neni 13

Struktura e Universitetit Politeknik të Tiranës

1. Struktura organizative e UPT, si një IAL publik, është objekt ndryshimi vetëm në funksion të llojeve dhe programeve të studimit që ai ofron.

Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës

2. UPT ka këtë strukturë bazë:
 - Administrata e Rektoratit
 - Fakultetet
 - Institutet e Kërkimit dhe Zhvillimit.
 - Njësi ndihmëse

3. Administrata e Rektoratit në UPT është i organizuar si më poshtë:
 - a) Sekretaria e Rektorit
 - b) Dega Mësimore
 - c) Dega Shkencore
 - d) Dega e Marrëdhënieve me jashtë
 - e) Dega Juridike
 - f) Dega e Financës
 - g) Dega e Investimeve dhe Shërbimeve
 - h) Dega e Burimeve Njerëzore, arshivë, protokoll, informacion, statistikë
 - i) Baza mekanike për praktika mësimore
 - j) Baza e shërbimit të mjeteve të transportit
 - k) Qendra e shërbimit dhe blerjeve
 - l) Qendra e edukimit në distancë
 - m) Sektori i shërbimit të rrjetit
 - n) Sekretare për Senatin dhe Këshillin e Administrimit

4. Fakultetet dhe institutet e kërkimit dhe zhvillimit, si njësi kryesore që bëjnë pjesë në UPT, janë organizuar si më poshtë:

I. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike

1. Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë
2. Departamenti i Elektroteknikës
3. Departamenti i Automatikës

II. Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave

1. Departamenti i Shkencave të Tokës
2. Departamenti i Gjeologjisë së Zbatuar, Mjedisit dhe Gjeoinformatikës
3. Departamenti i Inxhinierisë së Burimeve Minerare
4. Departamenti i Burimeve të Energjisë

III. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike

1. Departamenti i Energjetikës
2. Departamenti i Mekanikës
3. Departamenti i Prodhimit dhe Menaxhimit
4. Departamenti i Tekstilit dhe Modës

Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës

IV. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit

1. Departamenti i Arkitekturës dhe Urbanistikës
2. Departamenti i Konstruksioneve të Ndërtimit dhe Infrastrukturës së Transportit
3. Departamenti i Mekanikës së Strukturave
4. Departamenti i Inxhinierisë së Mjedisit
5. Departamenti i Hidroteknikës dhe Hidraulikës
6. Departamenti i Gjeodezisë

V. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit

1. Departamenti i Elektronikës dhe Telekomunikacionit
2. Departamenti i Inxhinierisë Informatike
3. Seksioni i Informatikës
4. Qendra e Kërkimit dhe Zhvillimit në Teknologjitë e Informacionit;

VI. Fakulteti i Formimit të Përgjithshëm (fakultet i asociuar)

1. Departamenti i Fizikës dhe Kimisë
2. Departamenti i Matematikës
3. Qendra e Gjuhëve të Huaja

VII. Instituti i Gjeoshkencave (IGJEO)

1. Departamenti i Gjeoresurseve dhe Gjeoinxhinierisë
2. Departamenti i Gjeofizikës dhe Gjeoriskut
3. Departamenti i Sizmologjisë dhe Inxhinierisë Sizmike
4. Departamenti i Teknologjive të Gjeoinformacionit

VIII. Instituti i Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (INEUM)

1. Departamenti i Teknologjive Energjetike;
2. Departamenti i Ekonomisë së Ujit;
3. Departamenti i Klimës dhe Mjedisit

5. Njësi ndihmëse të UPT:

IX .Biblioteka shkencore

Neni 14
Fakulteti në UPT

1. Fakulteti është njësi kryesore e UPT-së. Ai është i organizuar në përputhje me Ligjin Nr. 9741, dt. 21.05.2007, "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", dispozitat përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë si dhe në përputhje me vetë Statutin e Universitetit Politeknik i Tiranës.
2. Fakulteti i Universitetit Politeknik të Tiranës (FUPT) bashkërendon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fusha mësimore-kërkimore të përafërta ose të ndërthurura të aspekteve të ndryshme inxhinierike.
3. FUPT ofron programe të studimit të niveleve e cikleve të ndryshme, në përfundim të të cilave fitohet diplomë.
4. UPT propozon hapjen e fakulteteve të reja apo të tipit të asociuar. Në fakultetin e tipit të asociuar mund të bashkohen disiplina të cilat nuk përbëjnë një specialitet të vetë Universitetit Politeknik i Tiranës. Ky fakultet nuk lëshon diplomë.
5. FUPT organizohet në njësi bazë, dhe ka në përbërjen e tij të paktën tre të tilla, nga të cilat të paktën dy duhet të jenë departamente.
6. FUPT drejtohet nga dekani, i cili zgjidhet në përputhje me Ligjin Nr. 9741, dt. 21.05.2007, "Për arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet e tjera juridike të MASH dhe Këshillit të Ministrave.
7. FUPT ka strukturën e tij, e cila propozohet nga Rektorati dhe miratohet nga Këshilli i Administrimit të UPT.

Neni 15
Instituti në UPT

1. Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit (IKZH) që bën pjesë në UPT, kryen veprimtari kërkimore-shkencore dhe zhvillimi, si dhe merr pjesë në realizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë dhe të tretë.
2. Struktura, përbërja, funksionimi dhe drejtimi i Institutit të Kërkimit dhe Zhvillimit, përcaktohen me anë të këtij Statuti si dhe të rregulloreve që rrjedhin prej tij, në përputhje me Ligjin Nr. 9741, dt. 21.05.2007, "Për arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet e tjera juridike të MASH dhe KM.
3. Funksionimi i INEUM dhe IGJEO, për periudhën kalimtare sanksionohet në VKM Nr. 560 dhe 561, date 22.08.2007. Me mbarimin e kësaj periudhe këto institute do të funksionojnë sipas statutit të UPT.

Neni 16
Departamenti në UPT

1. Departamenti në Universitetin Politeknik të Tiranës (DUPT) është njësi bazë mësimore-kërkimore.
2. DUPT përfshin fusha kërkimi homogjene dhe grupon brenda tij disiplina mësimore respektive.
3. DUPT nxit, bashkërendon dhe administron mësimdhënien sipas programeve të studimit si dhe veprimtarinë kërkimore përkatëse.
4. DUPT ka në përbërjen e tij të paktën shtatë anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën tre duhet të kenë grada dhe tituj. Për rastet kur Departamentet nuk plotësojnë këtë kriter, atëherë veprohet në përputhje me Nenin 12, Pika 3 e Ligjit Nr. 9741, dt. 21.05.2007, "Për arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë".
5. DUPT i lind e drejta të organizohet në grupe mësimore dhe kërkimore, të përhershme ose të përkohshme.
6. Drejtuesit e grupeve të formuara brenda DUPT përzgjidhen me konkurs dhe emërohen nga Dekani/Drejtori i njësisë kryesore për një kohëzgjatje katër vjeçare ose për periudhën që funksionin grupi. Funksionet e drejtuesve të grupeve dhe procedurat e përzgjedhjes së tyre përcaktohen në Rregulloren e njësisë kryesore.
7. Vendimet e Departamentit merren kur pjesëmarrja në mbledhjen e përgjithshme të Departamentit është mbi 2/3 dhe kur shumica voton pro.

Neni 17
Qendra e kërkimit dhe zhvillimit në UPT

1. Qendra e Kërkimit dhe Zhvillimit në UPT ka strukturë të ngjashme me Departamentin.
2. Qendrës së Kërkimit dhe Zhvillimit që bën pjesë në UPT i lind e drejta të organizohet në grupe kërkimore, të përhershme ose të përkohshme.
3. Drejtuesit e grupeve të formuara brenda Qendrës së Kërkimit dhe Zhvillimit, përzgjidhen me konkurs dhe emërohen nga Përgjegjësi i Qendrës për një kohëzgjatje katër vjeçare ose për periudhën që funksionin grupi. Funksionet e drejtuesve të grupeve dhe procedurat e përzgjedhjes së tyre përcaktohen në Rregulloren e funksionimit të Qendrës.

KREU 3

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 18

Organet drejtuese dhe administruese

1. Organet drejtuese dhe administruese në UPT janë: senati akademik, rektorati, këshilli i administrimit, këshilli i etikës akademike dhe këshilli i fakultetit/Institutit.

Neni 19

Senati akademik

1. Senati akademik është organ kolegjal vendimmarrës, që përcakton politikat e zhvillimit të institucionit, programon, bashkërendon, drejton dhe kontrollon veprimtaritë e mësimdhënies e të kërkimit shkencor si dhe vlerëson efikasitetin e tyre. Senati akademik kryesohet nga rektori dhe mbledhet periodikisht.
2. Funksionet kryesore të senatit akademik janë:
 - a) garanton respektimin e parimeve të autonomisë dhe mundësive të barabarta të lirisë akademike e të kërkimit, si dhe të drejtat e studentëve;
 - b) miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe programin vjetor të veprimtarive të tij;
 - c) vendos me shumicën e votave të anëtarëve të tij projektbuxhetin e UPT, pasi merr miratimin nga këshilli i administrimit;
 - d) miraton ndarjen e burimeve financiare;
 - e) miraton projektstatutin me dy të tretat e votave të anëtarëve të tij;
 - f) miraton rregulloret që janë kompetencë e tij;
 - g) vlerëson dhe miraton programet e reja të studimit, të kërkimit e zhvillimit si dhe i propozon Ministrit të Arsimit dhe Shkencës hapjen apo mbylljen e programeve të reja të studimeve në universitet
 - h) Propozon hapjen, ndryshimin ose mbylljen e njësive mësimore dhe kërkimore;
 - i) vlerëson, garanton dhe mban përgjegjësi për sigurimin e brendshëm të cilësisë, në përputhje me standardet shtetërore;
 - j) vlerëson veprimtarinë mësimore-kërkimore të personelit akademik;
 - k) siguron që kryerja dhe vlerësimi i të gjitha provimeve të bëhet në përputhje me standardet e institucionit, që garantojnë cilësinë dhe transparencën e duhur etj.
 - l) i propozon Ministrit të Arsimit dhe Shkencës kuotat e pranimeve në Universitet, si dhe tarifat e regjistrimit dhe të studimeve;
 - m) kur e çmon të nevojshme, përcakton kritere të veçanta në përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në ciklin e parë, sipas propozimeve të këshillave të fakulteteve;

Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës

- n) përcakton kriteret e pranimit për kandidatët në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve, sipas propozimeve të këshillave të fakulteteve.
- o) për zgjedh anëtarët e Këshillit të etikës akademike
- p) shfuqizon, kryesisht apo me kërkesë të të interesuarit, vendimet e këshillit të fakultetit/institutit, kur bien ndesh me legjislacionin në fuqi;

3. Senati akademik kërkon mendimin e këshillit të administrimit për probleme që janë kompetencë e këtij të fundit.
4. Senati akademik përbëhet nga 38 anëtarë të zgjedhur + 1 (Rektori) që le detyrën në zgjedhjet e radhës. Përbërja e Senatit është:
 - Rektori i cili është dhe kryetar i senatit akademik;
 - 4 përfaqësues nga Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike;
 - 4 përfaqësues nga Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave;
 - 4 përfaqësues nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike;
 - 4 përfaqësues nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit
 - 4 përfaqësues nga Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit;
 - 4 përfaqësues nga Fakulteti i Formimit të Përgjithshëm
 - 3 përfaqësues nga Instituti i Gjeoshkencave;
 - 3 përfaqësues nga Instituti i Energjisë, Ujit dhe Mjedisit;
 - 1 përfaqësues nga personeli administrativ;
 - 6 përfaqësues nga studentët- një përfaqësues nga çdo Fakultet

Senati akademik ka në përbërjen e vet edhe anëtarë të jashtëm të tij, që përzgjidhen nga personalitete të shquara të fushave që mbulon UPT.

Në mbledhjet e Senatit merr/marrin pjesë Zv/rektori (Zv/Rektorët) pa të drejtë vote, kur nuk është/janë anëtarë të zgjedhur të senatit akademik.

5. Dekani/Drejtori i njësisë kryesore është anëtar i senatit akademik dhe përfshihet në numrin e përfaqësuesve të çdo fakulteti/instituti.
6. Senati akademik ka sekretarin/en e vet shkencor/e, i cili është Kryetari/ja i/e Degës Shkencore që bën zbardhjen e vendimeve të Senatit. Detyrat e tjera të tij/saj përcaktohen në rregulloren e brendshme të senatit.
7. Anëtarët e brendshëm të senatit akademik zgjidhen sipas procedurave të përcaktuara në këtë statut dhe në ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
8. Mandati i anëtarit të Senatit akademik mbaron kur:
 - a) përmbushet afati i mandatit;
 - b) jep dorëheqjen;
 - c) largohet nga UPT;
 - d) bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrijë funksionin;
 - e) kur nuk merr pjesë për 3 herë radhazi, pa shkaqe të arsyeshme në mbledhjen e Senatit akademik.

Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës

9. Vendi i mbetur bosh plotësohet në përputhje me pikën 3.5. të rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë për periudhën 2007-2011”.
10. Senati akademik mblidhet në seanca të zakonshme çdo 2 muaj. Në fillim të çdo viti akademik publikohet programi i punës së Senatit. Ai mund të mblidhet edhe në seanca të jashtëzakonshme me iniciativën e Kryetarit të senatit ose me kërkesën e një të tretës së anëtarëve të tij. Rendi i ditës propozohet nga Kryetari dhe miratohet nga anëtarët e senatit. Në rastet kur senati mblidhet në seancë të jashtëzakonshme me kërkesën e një të tretës së anëtarëve, rendi i ditës propozohet nga ky grup anëtarësh dhe miratohet nga anëtarët e senatit. Vendimet e senatit janë të vlefshme vetëm kur në votim kanë marrë pjesë jo më pak se dy të tretat e anëtarëve të tij dhe kur shumica e tyre voton “pro”. Rregullat mbi procedurën e votimit dhe çështje të tjera që lidhen me të, përcaktohen në rregulloren e brendshme të senatit.
11. Senati në ushtrimin e funksionit të tij shprehet me vendime.
12. Vendimet e Senatit bëhen publike.

Neni 20 **Rektorati**

1. Rektorati është organ kolegjal ekzekutiv që përbëhet nga:
 - a) rektori;
 - b) zëvendësrektori/zëvendësrektorët;
 - c) dekani/drejtori i njësisë kryesore
 - d) kancelari i universitetit.

Rektorati kryesohet nga rektori.

2. Funksionet kryesore të rektoratit janë:
 - a) harton planin disavjeçar të zhvillimit të institucionit;
 - b) harton programin vjetor të veprimtarive, si dhe ndjek zbatimin e tij pas miratimit në senatin akademik;
 - c) formulon kriteret për shpërndarjen e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore;
 - d) parashtron përparësitë mes kërkesave konkurruese për financime mes njësive kryesore të UPT;
 - e) harton dhe propozon projektbuxhetin për miratim në senatin akademik;
 - f) harton planin për investime, kontratat dhe marrëveshjet që janë kompetencë e tij;
 - g) paraqet rekomandime për projektet për programet e studimeve, të kërkimit shkencor dhe ndryshimet e nevojshme strukturore për realizimin e tyre;
 - h) zbaton të gjitha vendimet e miratuara nga senati akademik dhe këshilli i administrimit;

Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës

- i) monitoron veprimtarinë e UPT dhe publikon rezultatet e vlerësimit të tij.
 - j) përgatit marrëveshjen ndërmjet UPT dhe MASH për rregullat e financimit;
 - k) propozon strukturën e përgjithshme dhe numrin e personelit të UPT për të gjitha nivelet;
 - l) përgatit rregulloren e tij të punës, që miratohet nga senati akademik;
 - m) harton rregulloren për administrimin, financat dhe kontabilitetin dhe ia paraqet për miratim këshillit të administrimit;
 - n) ofron infrastrukturën dhe shërbimin administrativ për mbarëvajtjen dhe funksionimin e organeve dhe autoriteteve drejtuese të Universitetit;
 - o) ushtron kontrole tematike, të organizuara apo spontane në njësitë e Universitetit për përmbushjen e qëllimeve të tij, si dhe për zbatimin e akteve të organeve të Universitetit.
3. Rektori kërkon mendimin e senatit akademik dhe të këshillit të administrimit për aspekte të kompetencës së këtyre të fundit.
 4. Rektori raporton një herë në semestër në senatin akademik dhe në këshillin e administrimit për realizimin e planit të veprimtarive
 5. Rektori harton raportin vjetor të veprimtarisë mësimore-kërkimore dhe ia paraqet atë për miratim senatit akademik dhe këshillit të administrimit, brenda muajit Janar të vitit pasardhës.
 6. Rektori harton raportin vjetor të veprimtarisë financiare dhe ia paraqet atë për miratim senatit akademik dhe këshillit të administrimit në fund të vitit kalendarik
 7. Rektori ka të drejtë t'ia delegojë kompetencat personelit apo organit tjetër të institucionit në përputhje me rregulloren e tij.
 8. Detyrat dhe funksionimi i Rektorit sanksionohen në Rregulloren e tij të hartuar në përputhje me këtë Statut

Neni 21

Këshilli i Administrimit

1. Këshilli i administrimit është organ kolegjal vendimmarrës, që mbikëqyr e kontrollon veprimtarinë e universitetit, që lidhen me menaxhimin administrativ, financiar, ekonomik dhe të pronave të tij.
2. Funksionet kryesore të këshillit të administrimit janë:
 - a. miraton kriteret për ndarjen e burimeve financiare;
 - b. miraton, me kërkesën e senatit akademik, projektbuxhetin e institucionit me dy të tretat e votave;
 - c. vlerëson efikasitetin e përdorimit të fondeve nga Buxheti i Shtetit ose burime të tjera të ligjshme dhe publikon rezultatet e vlerësimit;
 - d. miraton strukturën dhe numrin e personelit të institucionit për të gjitha nivelet;
 - e. miraton raportin vjetor financiar të paraqitur nga Rektori;

Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës

- f. vlerëson planin e zhvillimit të institucionit e programin vjetor të veprimtarive të tij;
 - g. miraton rregulloren e brendshme për administrimin, financat dhe kontabilitetin;
 - h. miraton rregulloren e funksionimit të tij;
 - i. informon Senatin Akademik dhe Rektoren për situatën financiare dhe projektet përkatëse për të gjithë Universitetin.
3. Rektori dhe kancelari i institucionit kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e këshillit të administrimit, pa të drejtë vote, kur e vlerësojnë ata vetë, si dhe kur thirren nga ky këshill.
 4. Këshilli i administrimit përbëhet nga 17 anëtarë:
 - a- përfaqësues të zgjedhur nga UPT (9 anëtarë)
 - 1 përfaqësues nga Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike;
 - 1 përfaqësues nga Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave;
 - 1 përfaqësues nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike;
 - 1 përfaqësues nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit
 - 1 përfaqësues nga Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit;
 - 1 përfaqësues nga Fakulteti i Formimit të Përgjithshëm
 - 1 përfaqësues nga Instituti i Gjeoshkencave;
 - 1 përfaqësues nga Instituti i Energjisë, Ujit dhe Mjedisit;
 - 1 përfaqësues nga studentët
 - b- 8 anëtarë të emëruar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, përfaqësues nga fushat e shkencës, ekonomisë, kulturës, autoritete të pushtetit qendror dhe vendor;
 5. Anëtarët sipas shkronjës “b” të pikës 4 të këtij neni, emërohen dhe shkarkohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës. Numri i anëtarëve të emëruar është një më pak se gjysma e numrit të anëtarëve të Këshillit të administrimit. Këshilli i administrimit zgjedh kryetarin, prej anëtarëve të brendshëm të tij, me dy të tretat e votave të të gjithë anëtarëve.
 6. Anëtarësia në Këshillin e Administrimit është e papajtueshme me detyrën e anëtarit të senatit akademik, të zëvendësrektorëve, të dekanëve/drejtorëve dhe të zëvendësdekanëve/zëvendësdrejtorëve.
 7. Mandati i anëtarit të Këshillit të Administrimit mbaron kur:
 - a. përmbushet afati i mandatit;
 - b. jep dorëheqjen;
 - c. largohet nga UPT, për ata që janë caktuar sipas pikës 4, shkronjat “a” të këtij neni;
 - d. bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrijë funksionin;
 - e. kur nuk merr pjesë, për 3 herë radhazi, pa shkaqe të arsyeshme në mbledhjen e Këshillit të Administrimit;

Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës

f. për anëtarët që janë emëruar sipas pikës 4, shkronja “b”, të këtij neni, kur lirohen me akt të ministrit.

8. Vendi i mbetur vakant për anëtarët që zgjidhen nga personeli akademik, plotësohet në përputhje me pikën 3.5. të rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë për periudhën 2007-2011”.
9. Mënyra e thirrjes së mbledhjeve, rendi i ditës, pjesëmarrja, shumica për marrjen e vendimeve dhe çështjet e tjera të lidhura me to parashikohen në rregulloren e brendshme të Këshillit të Administrimit.

Neni 22

Këshilli i etikës akademike

1. Këshilli i etikës akademike ngrihet pranë UPT dhe diskuton probleme të etikës së jetës universitare.
2. Këshilli i etikës akademike të UPT përbëhet nga 9 anëtarë
 - a. 1 përfaqësues nga Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike;
 - b. 1 përfaqësues nga Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave;
 - c. 1 përfaqësues nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike;
 - d. 1 përfaqësues nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit
 - e. 1 përfaqësues nga Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit;
 - f. 1 përfaqësues nga Fakulteti i Formimit të Përgjithshëm
 - g. 1 përfaqësues nga Instituti i Gjeoshkencave;
 - h. 1 përfaqësues nga Instituti i Energjisë, Ujit dhe Mjedisit;
 - i. 1 përfaqësues nga studentet
3. Anëtarët e këshillit të etikës akademike përzgjidhen nga senati akademik.
4. Antarët e Këshillit të etikës akademike zgjedhin kryetarin e tij .
5. Këshilli i etikës akademike harton rregulloren e etikës së universitetit e cila miratohet nga Senati akademik i UPT

Neni 23

Këshilli i Fakultetit

1. Këshilli i Fakultetit është organ kolegjal vendimmarrës, që programon e përcakton, në bazë të propozimeve të departamenteve, përdorimin e burimeve njerëzore dhe materiale në dispozicione të fakultetit. Ai propozon për programe të reja studimi ose të kërkimit shkencor; për hapje, ndryshim ose mbyllje departamentesh ose njësisish të tjera; merr vendime për problemet financiare të fakultetit, në përputhje me autoritetin që i është deleguar atij; shqyrton dhe

Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës

miraton raportin vjetor të dekanit për veprimtarinë mësimore dhe të kërkimit shkencor. Këshilli i fakultetit i propozon senatit akademik planin strategjik të zhvillimit të fakultetit dhe mbikëqyr realizimin e tij.

2. Këshilli i fakultetit kryesohet nga dekani.
3. Përveç kompetencave të përcaktuara në piken 1, të këtij neni, Këshilli i fakultetit ushtron edhe këto kompetenca:
 - a) miraton rregulloren e fakultetit;
 - b) i paraqet Rektoratit strukturën dhe numrin e punonjësve në fakultet;
 - c) shpall projektet fituese, për t'u financuar nga fondet për kërkim shkencor nga buxheti i fakultetit, si dhe bursat për studime shkencore, që administrohen nga vetë fakulteti;
 - d) miraton listën e periodikëve shkencorë ku do të pajtohet fakulteti, si dhe titujt e librave që do të blihen për bibliotekën e fakultetit;
 - e) miraton mënyrën e përdorimit të dhurimeve që janë kryer në favor të një departamenti, duke marrë parasysh propozimin e departamentit përfitues;
 - f) ushtron edhe kompetenca të tjera që përcaktohen në rregulloren e Universitetit apo të Fakultetit, bazuar në specifikën e secilit Fakultet;Në ushtrimin e kompetencave të tij këshilli shprehet me vendime.

Neni 24

Këshilli i Institutit të kërkimit dhe zhvillimit

Këshilli drejtues i Institutit të kërkimit dhe zhvillimit ka këto kompetenca:

1. Harton kuadrin rregullator të veprimtarisë së Institutit;
2. Përgatit strukturën dhe organikën e Institutit dhe ia paraqet për miratim Rektorit;
3. Harton planin afatgjatë të zhvillimit të Institutit dhe ia paraqet për miratim, Senatit Akademik;
4. Përcakton fushat parësore të kërkimit dhe, në varësi të tyre, i propozon Senatit Akademik grupet kërkimore-mësimore, që do të ngrihen në Institut.
5. Përcakton kriteret e punësimit të personelit akademik, për fazën kalimtare, sipas VKM Nr. 560 dhe 561, date 22.03.2007;
6. Drejton procedurat e konkursit të hapur, për emërimin e titullarëve të grupeve kërkimore-mësimore, për fazën kalimtare;

Neni 25

Këshilli i profesorëve

1. Këshilli i profesorëve ngrihet pranë fakulteteve të cilat ofrojnë programe studimi të ciklit të tretë, për organizimin dhe drejtimin e studimeve të doktoratës dhe të kualifikimit shkencor e pedagogjik pas doktoratës.

Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës

2. Në përbërje të tij bën pjesë gjithë personeli akademik me titullin "Profesor". Këshilli i profesorëve përbëhet minimalisht nga shtatë anëtarë.
3. Në fakultetet që nuk plotësohet numri i nevojshëm, këshilli i profesorëve plotësohet nga profesorë të fushave të përafërta me fakultetin përkatës. Në këtë rast personi që merr pjesë në këshillin e profesorëve të fakultetit, është anëtar i të dy këshillave.
4. Funksionet dhe detyrat e Këshillit të Profesorëve përcaktohen në rregulloren e KP-së, e cila miratohet nga Senati akademik i UPT.

Neni 26 **Autoritetet drejtuese**

Autoritetet drejtuese në UPT janë:

1. rektori;
2. dekani/drejtori;
3. përgjegjësi i departamentit/qendrës së kërkimit dhe zhvillimit.

Neni 27 **Rektori**

1. Rektori është autoriteti drejtues i UPT, i cili e përfaqëson atë dhe vepron në emër dhe për llogari të tij.
 2. Rektori ushtron këto funksione:
 - a- drejton universitetin në të gjitha aspektet e veprimtarisë së tij akademike, kërkimore - shkencore, administrative e financiare.
 - b- Drejton hartimin e planit strategjik të zhvillimit të institucionit dhe ndjek zbatimin e tij.
 - c- paraqet propozimet për aktet që janë në kompetencë për t'u shqyrtuar nga Senati Akademik, Këshilli i Administrimit apo Këshilli i Etikës Akademike
 - d- nënshkruan, në emër të UPT, marrëveshje e protokolle bashkëpunimi me universitetet e tjera, vendase dhe të huaja, dokumentacione për anëtarësimin e UPT në shoqata dhe organizata kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë, marrëveshje bashkëpunimi me subjekte vendase dhe të huaja që ndihmojnë në zhvillimin e arsimit të lartë. Këto marrëveshje, protokolle e bashkëpunime i paraqiten Senatit për ratifikim
 - e- përfaqëson UPT në marrëdhënie me të tretët;
 - f- si kryetar i Senatit, ka të drejtën e vetos mbi vendimet e tij, duke ia kthyer këtij organi për rishqyrtim. Kur Senati, mbas rishqyrtimit, nuk e ndryshon vendimin, ky vendim tashmë është i formës së prerë;
 - g- shfuqizon, kryesisht apo me kërkesën e të interesuarit, aktet e dekanit/drejtorit , kur bien ndesh me legjislacionin në fuqi;
 - h- miraton strukturën dhe organikën e personelit të Universitetit;

Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës

- i- emëron punonjësit e personelit akademik, kryetarët e degëve dhe specialistët në rektorat, duke iu përmbajtur kritereve për zënien e këtyre vendeve;
 - j- nënshkruan kontratat e punës me punonjësit akademikë dhe administrativë;
 - k- nënshkruan diplomatat e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë, pa të drejtë për të deleguar nënshkrimin;
 - l- ngre komisione e grupe pune për çështje, studime e veprimtari të veçanta.
3. Mandati i Rektorit mbaron kur:
- a) përfundon afati i mandatit;
 - b) jep dorëheqjen;
 - c) bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrijë funksionin;
 - d) në rastin e parashikuar në pikën 3, të nenit 64, të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”.
4. Marrëdhëniet e Rektorit me organet e tjera, mënyra dhe kushtet e ushtrimit të kompetencave të tij parashikohen në rregulloren e Rektoratit dhe të UPT .

Neni 28 **Dekani/Drejtori**

1. Dekani/Drejtori është autoriteti drejtues i njësisë kryesore dhe përfaqësuesi ligjor i saj.
2. Dekani/drejtori kryen këto funksione :
 - a) përgatit propozimin përkatës për çdo vendimmarrje të Këshillit të njësisë kryesore;
 - b) përgjigjet para Këshillit të njësisë kryesore për mbarëvajtjen e aktivitetit të njësisë
 - c) i propozon Këshillit të Fakultetit hapjen apo mbylljen e programeve të studimit si dhe reformimin e kurrikulave, të departamenteve apo njësive të veçanta në fakultet.
 - d) si kryetar i Këshillit, ka të drejtën e vetos mbi vendimet e tij, duke ia kthyer këtij organi për rishqyrtim. Kur Këshilli, mbas rishqyrtimit, nuk e ndryshon vendimin, ky vendim tashmë është i formës së prerë.
3. Dekani/Drejtori në ushtrim të kompetencave të tij, shprehet me urdhra dhe udhëzime.
4. Marrëdhëniet e Dekanit/Drejtorit me organet e tjera, mënyra dhe kushtet e ushtrimit të kompetencave të tij parashikohen në rregulloren e njësisë kryesore.

Neni 29 **Përgjegjësi i departamentit/Qendrës së kërkimit dhe zhvillimit**

- 1- Përgjegjësi i Departamentit/Qendrës së kërkimit dhe zhvillimit është autoriteti drejtues i njësisë bazë.

- 2- Pozita juridike e përgjegjësit të departamentit/qendrës së kërkimit dhe zhvillimit, marrëdhëniet e tij me personelin akademik, me organet e tjera, si dhe me të tretët, përcaktohen në rregulloren e njësisë kryesore.

Neni 30

Zgjedhja e organeve dhe e autoriteteve drejtuese

1. Në UPT organet dhe autoritetet drejtuese zgjidhen.
2. Përbërja e organeve drejtuese në UPT është:
 - a) senati akademik përbëhet nga anëtarë, personel akademik, personel joakademik dhe studentë, të cilët zgjidhen drejtpërdrejt nga grupet përkatëse të anëtarëve të institucionit;
 - b) këshilli i fakultetit përbëhet nga anëtarë të personelit akademik, të personelit joakademik dhe studentë, të zgjedhur drejtpërdrejt nga grupet përkatëse të anëtarëve të fakultetit;
 - c) Këshilli i Institutit të kërkimit dhe zhvillimit përbëhet nga anëtarë të personelit të tyre akademik dhe përfaqësues të personelit jo akademik, të zgjedhur drejtpërdrejt nga grupet përkatëse të anëtarëve të institutit.
 - d) senati akademik dhe këshillat e fakulteteve, përbëhen 15 për qind nga studentë, 5 për qind nga personel joakademik dhe pjesa tjetër nga personel akademik.
 - e) Këshilli i Institutit përbëhet nga 20 % personel joakademik dhe 80 % personel akademik.
3. Autoritetet drejtuese në UPT zgjidhen sipas modaliteteve të mëposhtme:
 - a) rektori zgjidhet me votim të fshehtë nga i gjithë personeli akademik, personel joakademik dhe studentët e institucionit;
 - b) dekani zgjidhet me votim të fshehtë nga i gjithë personeli akademik, personel joakademik dhe studentët e fakultetit;
 - c) drejtori i institutit zgjidhet me votim të fshehtë nga i gjithë personeli i institutit.
 - d) përgjegjësi i departamentit/qendrës së kërkimit dhe zhvillimit zgjidhet me votim të fshehtë nga i gjithë personeli akademik respektiv.
4. Në zgjedhjen e autoriteteve drejtuese, votat e studentëve dhe votat e personelit joakademik përlllogariten me përqindje, ato vlejné 20 për qind në totalin e përgjithshëm të votave për studentët dhe 5 për qind në totalin e përgjithshëm të votave për personelin joakademik.
5. Presidenti i Republikës emëron rektorin e zgjedhur. Rektori emëron dekanin/drejtorin e zgjedhur. Dekani/drejtori emëron përgjegjësin e zgjedhur të departamentit/qendrës së kërkimit dhe zhvillimit.
6. Përbërja e këshillave të njësisë kryesore dhe mënyra e përfaqësimit të çdo njësie bazë në to, përcaktohen në Rregulloret e funksionimit të njësisë kryesore.

Neni 31
Autoritete të tjera

Autoritete të tjera në UPT janë:

1. zëvendësrektorët
2. kancelari i Universitetit
3. zëvendësdekani/ët apo zëvendës drejtori/ët
4. kancelari i njësisë kryesore

Neni 32
Zëvendësrektori

1. Zëvendësrektori emërohet dhe shkarkohet nga Rektori, pas miratimit të kandidaturave të propozuara prej tij në Senatin Akademik.
2. Zëvendësrektori kryen funksionet e përcaktuara në Rregulloren e UPT.
3. Në mungesë dhe me porosi të Rektorit, nënshkruan aktet përkatëse në emër të UPT.
4. Procedurat e emërimit apo shkarkimit të Zv/Rektorit përcaktohen në Rregulloren e funksionimit të UPT.

Neni 33
Kancelari i UPT

1. Kancelari i UPT është përgjegjës për drejtimin e përditshëm, administrativ dhe financiar të institucionit, për zbatimin e buxhetit, për mbikëqyrjen dhe kontrollin e veprimeve financiare, si dhe për zbatimin e ligjshmërisë.
2. Kandidatura për kancelarin e Universitetit përzgjidhet nga Këshilli i Administrimit dhe Rektori ia paraqet atë Ministrit të Arsimit dhe Shkencës për miratim. Kancelari duhet të ketë formim universitar, juridik ose ekonomik dhe së paku 5 vjet përvojë pune.
3. Kancelari ushtron këto funksione:
 - a) përgjigjet për veprimtarinë ekonomike dhe financiare të Universitetit, me përjashtim të kompetencave ekskluzive të Këshillit të Administrimit;
 - b) propozon studime për zhvillimin perspektiv të Universitetit;
 - c) organizon kryerjen e kontroll-revizionit financiar të Universitetit;
 - d) përfaqëson UPT si firmë e parë e deleguar nga Rektori në marrëdhëniet financiare me Bankën e Shtetit dhe në të gjitha marrëdhëniet kontraktore me të tretët, brenda fushave që ai mbulon;
 - e) thërret në raport kancelarët dhe kryetarët e degëve ekonomike të njësisë kryesore;
 - f) Funksionet të tjera të Kancelarit përcaktohen në Rregulloren e Rektoratit dhe të UPT.

Neni 34

Zëvendësdekani/Zëvendësdrejtori

1. Zëvendësdekani/zëvendësdrejtori emërohet dhe shkarkohet nga dekani/drejtori, pas miratimit të kandidaturave të propozuar prej tij në Këshillin e Fakultetit/Institutit të kërkimit dhe zhvillimit.
2. Funkcionet dhe procedurat e emërimit/shkarkimit të zëvendësdekanit/zëvendësdrejtorit përcaktohen në rregulloren e njësisë kryesore .

Neni 35

Kancelari i njësisë kryesore

1. Kancelari i fakultetit/institutit është përgjegjës për drejtimin e përditshëm, administrativ dhe financiar, për zbatimin e buxhetit, për mbikëqyrjen dhe kontrollin e veprimeve financiare, si dhe për zbatimin e ligjshmërisë.
2. Funkcionet e kancelarit përcaktohen në rregulloren e njësisë kryesore.

KREU 4

PRONAT DHE FINANCIMI I UPT

Neni 36

Parime të përgjithshme të financimit të UPT

1. UPT administron këto prona:
 - Godinën e Korpusit qendror të UPT – Sheshi “Nënë Tereza, Nr. 4, Tiranë
 - Godinën e FIN – Rruga “Muhamet Gjolleša”
 - Godinën e FGjM – Rruga e Elbasanit
 - Katin e parë të godinës së Rektoratit të UT – Biblioteka e UPT
 - Godinën e ish ISP – Nr 1 – Blloku “Vasil Shanto”
 - Ambientet e ofiçinave –
 - Pasuritë e paluajtshme të INEUM dhe IGJEO, të cilat me VKM Nr. 560 dhe 561 i janë transferuar UPT.

2. UPT funksionon sipas parimit të autonomisë financiare.

3. Baza ligjore e veprimtarisë financiare të UPT është:
 - a) Ligji Nr. 9741, date 21.5.2007 “Për Arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij të nxjerra nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës si dhe Ministria e Financave;
 - b) Ligji Nr. 9720, date 23.4.2007 “Për auditin e brendshëm në sektorin publik” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij të nxjerra nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës si dhe Ministria e Financave;
 - c) Statuti i UPT;
 - d) Rregullore e Brendshme e UPT për Administrimin, Financimin dhe Kontabilitetin;
 - e) Rregulloren e Brendshme të Këshillit të Administrimit të UPT.

4. Universiteti Politeknik financohet nga:
 - b) transferta nga Buxheti i Shtetit;
 - c) të ardhura të krijuara nga UPT;
 - d) burime të tjera me destinacion;

5. Të ardhurat financiare që vijnë nga transfertat e pakushtëzuara të buxhetit të Shtetit përdoren në përputhje me rregullat e standardet e programimit buxhetor dhe menaxhimit financiar publik.

6. Të ardhurat e krijuara nga UPT përdoren tërësisht prej tij dhe pjesa e papërdorur e tyre mbartet në vitin pasardhës. Shpenzimi i të ardhurave të krijuara bëhet në përputhje me procedurat e buxhetit afatmesëm.
7. Në përdorimin e burimeve financiare përparësi kanë të ardhurat e veta.
8. Të gjitha transaksionet financiare në UPT kryhen nëpërmjet sistemit të thesarit.
9. UPT publikon çdo vit raportin e vet për veprimtarinë financiare të universitetit dhe e ve atë në dispozicion të publikut, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

Neni 37

Të ardhurat e krijuara nga UPT dhe përdorimi i tyre

1. Të ardhurat që krijohen nga UPT përbëhen nga:
 - a) të ardhurat nga tarifat e studimeve;
 - b) të ardhura nga organizimi i trajnimeve ose kualifikimeve për të tretë, sipas marrëveshjeve të lidhura;
 - c) të ardhura nga kryerja e punimeve kërkimore të porositura dhe shërbimeve të tjera të specializuara;
 - d) të ardhura që krijohen nga dhënia e aktiveve në përdorim për palët e treta në formën e kontratave të qiradhënies apo me forma të tjera kontraktimi;
 - e) të ardhura nga financimet e pakthyeshme të marra nga burime të huaja në kuadrin e projekteve dy e shumëpalëshe;
 - f) të ardhura nga dhuratat, trashëgimitë dhe donacionet publike;
 - g) të ardhura nga financime të tjera të ligjshme, nga burime të ndryshme.
2. Të ardhurat e krijuara sipas pikës 1 të këtij neni derdhen 100% në llogarinë e UPT. Mënyra e përdorimit të tyre përcaktohet në këtë Statut dhe në Rregulloren e Brendshme të UPT për Administrimin, Financimin dhe Kontabilitetin

Neni 38

Tarifat e studimeve

1. Tarifa e studimeve përbëhet nga tarifa e regjistrimit dhe tarifa e shkollimit.
2. Fakultetet e UPT i propozojnë Rektoratit çdo vit masën e tarifës së regjistrimit, kurse UPT i propozon Ministrit të Arsimit dhe Shkencës masën e unifikuar të kësaj tarife.
3. Fakultetet UPT i propozojnë Rektoratit çdo vit masën e tarifës së shkollimit për sistemin e studimeve në distancë. Tarifat e propozuara në çdo rast nuk mund të kalojnë vlerën e kostos së studimeve. UPT përcjell propozimet e tyre në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.
4. Studentët e shkëlqyer nuk e paguajnë tarifën e shkollimit në vitin akademik pasardhës, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore.

5. Të ardhurat e UPT që realizohen nga tarifa e shkollimit për ciklin e parë dhe ciklin e dytë të studimeve ndahen ndërmjet njësive kryesore të UPT në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore.

Neni 39

Hartimi i buxhetit të UPT

1. Struktura e hartimit të buxhetit të UPT bëhet sipas modelit të Buxhetit të Shtetit të përcaktuar në udhëzimin përkatës të Ministrit të Financave.
2. Projektbuxheti i UPT hartohet nga Rektorati duke u mbështetur në programin buxhetor afatmesëm 3-vjeçar dhe në propozimet e ardhura nga njësiti përbërëse të UPT.
3. Projektbuxheti miratohet nga Këshilli i Administrimit të UPT dhe më pas nga Senati Akademik. Më tej projektbuxheti i përcillet për miratim Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.
4. UPT e detajon buxhetin e tij sipas rektoratit, njësive përbërëse kryesore dhe njësive bazë të tij. Të gjitha këto njësi janë autonome në administrimin e buxhetit të tyre sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 40

Kontrolli dhe auditimi i brendshëm në UPT

- Kontrolli dhe auditimi i brendshëm në UPT realizohet nga njësia e Auditit të brendshëm.
- Fusha e veprimit të kësaj njësie dhe funksionimi i saj bëhet në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 9720, date 23.4.2007 "Për auditin e brendshëm në sektorin publik" dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.
- Njësia e Auditit të brendshëm varet nga Rektori.
- Rezultatet e kontrollit dhe auditit bëhen publike.

Neni 41

Rregullat e administrimit dhe të raportimit financiar

- Rregullat e përgjithshme të administrimit dhe raportimit financiar të UPT janë të njëjta me ato të çdo institucioni tjetër publik.
- Rregulla të veçanta dhe specifike për administrimin dhe raportimin financiar përcaktohen në Rregulloren e Brendshme të UPT për Administrimin, Financimin dhe Kontabilitetin.

Neni 42

Dokumentimi i shërbimeve dhe pronave të UPT

- 1 - Rektorati dhe njësitë kryesore të UPT duhet:
 - a) të publikojnë listën e të gjitha shërbimeve standarde që kryejnë, me tarifat përkatëse të shërbimit si dhe gjithë shërbimet dhe ekspertizat e tjera që mund të kryejnë;
 - b) të inventarizojnë, marketizojnë dhe dokumentojnë të gjitha pronat e paluajtshme që ka në përdorim si dhe aktivet e mundshme për dhënie në përdorim për palët e treta;
- 2- Kopje të dokumentacionit të mësipërm vihen ne dispozicion te Rektoratit

Neni 43

Fondi i promovimit

- Në buxhetin e UPT parashikohet fondi i promovimit.
- Ky fond përdoret për të promovuar produktet e UPT.
- Masa e këtij fondi miratohet nga Këshilli i Administrimit dhe mënyra e përdorimit përcaktohet në rregulloren e brendshme për Administrimin, Financimin dhe Kontabilitetin.

Neni 44

Transferta e pakushtëzuar

- UPT përdor transferta të pakushtëzuar për financimin e shpenzimeve që lidhen me funksionimin e tij.
- UPT përdor transfertë të pakushtëzuar edhe për financimin e investimeve me karakter të vazhdueshëm.
- UPT përdor transfertë të pakushtëzuar edhe për financimin e kërkimit shkencor.

Neni 45

Transfertë me konkurim për investime

1. Transferta me konkurim për investime përdoret për:
 - a) financimin e investimeve me karakter ndërtimi
 - b) për projekte të tjera të mëdha sipas klasifikimit në procedurat për menaxhimin e investimeve publike.
 - c) për projekte të kërkimit shkencor.
2. UPT u garanton njësitë kryesore të tij mundësi të barabarta për të përfituar nga financimet e Buxhetit të Shtetit nëpërmjet transfertave me konkurim, sipas pikave a dhe b të këtij neni. Rektorati i UPT bën sugjerimet e tij dhe inkurajon pjesëmarrjen në to të njësive përbërëse të UPT.

3. UPT u garanton punonjësve akademikë të tij mundësi të barabarta për të përfituar nga financimet e Buxhetit të Shtetit nëpërmjet transfertave me konkurim.
4. Në çdo rast aplikantëve u garantohej minimalisht 2 muaj kohë, nga data e shpalljes së ofertave, për t'u njohur me ofertat, për të përgatitur dhe paraqitur projektet.

Neni 46

Financime jashtë buxhetit të shtetit

UPT dhe njësitë përbërëse të tij konkurojnë me programe dhe projekte specifike të nxitura nga administrata shtetërore, nga entet jopublike ose private si dhe nga institucionet ndërkombëtare. Për të inkurajuar pjesëmarrjen në këto projekte hartuesit e projekteve shpërblehen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 47

Çmime akademike për studentë

1. Për të nxitur veprimtarinë mësimore dhe shkencore të studentëve, krijimin e shembujve, praktikave dhe modeleve të punës së mirë, Rektori në bashkëpunim me Këshillat e Fakulteteve, krijojnë çmime akademike specifike për studentë, me emërtime dhe shpërblime përkatëse.
2. Masa e shpërblimit për çdo çmim miratohet nga Këshilli i Administrimit. Dhënia e çmimeve bëhet me ceremoni vjetore në shkallë universiteti dhe dorëzimi i tyre bëhet nga Rektori, në prani të përfaqësuesve të Senatit, të profesoratit, administratës dhe studentëve.

KREU 5

PERSONELI

Neni 48

Personeli i UPT

Personeli i UPT përbëhet nga personeli akademik, personeli ndihmës mësimor-shkencor dhe personeli administrativ.

Neni 49

Personeli akademik

1. Personeli akademik gëzon status të veçantë. Në përputhje me përcaktimin e nenit 51 të ligjit të arsimit të lartë Nr. 9741, dt. 21.05.2007, aspektet e trajtimit të veçantë dhe përfitimet e tjera për personelin akademik rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Personeli akademik kryen veprimtari të mësimdhënies, kërkim shkencor baze dhe/ose të aplikuar, shërbime për zhvillim të institucionit, konsultim dhe këshillim për studentët dhe detyra administrative. Raportet ndërmjet veprimtarive të ndryshme përcaktohen në rregulloren e UPT dhe janë pjesë e kontratave të punës mes palëve.

3. Personeli akademik në UPT, sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, kategorizohet në: a) profesorë; b) docentë dhe c) lektorë.

a. Në kategorinë “Profesorë” janë anëtarët e personelit akademik, titullarë të lëndëve ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë së kërkimit shkencor. Anëtarët e personelit akademik të kësaj kategorie kanë gradën shkencore “Doktor” dhe titujt akademikë: “Profesor i asociuar”, “Profesor”, “Profesor emeritus” dhe “Akademik”.

b. Në kategorinë “Docentë” janë anëtarët e personelit akademik, që zhvillojnë kryesisht veprimtari mësimore. Anëtarët e personelit akademik të kësaj kategorie kanë titullin akademik “Docent” ose gradën shkencore “Doktor”.

c. Në kategorinë “Lektorë” janë anëtarët e personelit akademik që zhvillojnë veprimtari mësimore-kërkimore. Lektorët duhet të kenë diplomë “Master i Nivelit të Dytë” dhe të përmbushin kriteret që përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

4. Numri i përgjithshëm i personelit në UPT miratohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës. Struktura dhe organika e personelit të UPT për të gjitha nivelet miratohet nga Rektori UPT.

Neni 50

Personeli akademik i ftuar

1. Për të plotësuar nevojat e procesit mësimor, këshillat e fakulteteve/instituteve, me propozim të departamenteve, ftojnë për veprimtari mësimore e kërkimore personel akademik, sipas kërkesave të vendit të punës, për periudha semestrale ose njëvjeçare të përsëritshme.
2. Përzgjedhja e personelit akademik të ftuar duhet të kombinojë nevojën e njësisë për mësimdhënie ose kërkim shkencor me kualifikimet e tyre.
3. Kriteria të detajuara për aktivizimin dhe përzgjedhjen e lektorëve të ftuar përcaktohen në rregulloret e njësisë përkatëse kryesore.

Neni 51

Personeli akademik me kontratë

1. UPT ka të drejtë të punësojë, me kontratë, personalitete vendase ose të huaja, për periudha të shkurtra kohe deri në një semestër. Ky personel punësohet me vendim të Rektorit, sipas propozimeve të njësisë kryesore të UPT.
2. UPT ka të drejtë të punësojë, mbi bazën e një kontrate të përkohshme, edhe studentë në procesin e kryerjes së studimeve të doktoratës dhe të përgatitjes së disertacionit për gradën shkencore "Doktor", të cilët mbështesin profesorët udhëheqës të disertacionit në procesin mësimor dhe gjatë kësaj periudhe trajtohen si "Lektor".
3. Kontrata nënshkruhet nga rektori duke parashikuar të gjithë elementët që përmbajnë dispozitat ligjore përkatëse. Të punësuarit me kontratë duhet të kenë përfunduar të paktën nivelin "Master" i nivelit të dytë. Kriteria të veçanta të punësimit dhe procedurat e përzgjedhjes, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, përcaktohen në rregulloret e UPT, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore.
4. Shpenzimet për personelin akademik të përcaktuar në nenet 50 dhe 51 përballohen nga të ardhurat e UPT.

Neni 52

Punësimi në UPT

1. Vendet e punës për personelin akademik, personelin ndihmës mësimor-shkencor dhe personelin administrativ në UPT fitohen me konkurim. Përfshihen nga konkurimi vetëm vendet e punës për personelin e shërbimit.
2. Kriteri i përgjithshëm i konkurimit për stafin akademik që do të punësohet në UPT është:
 - a. Të ketë mbaruar studimet universitare me një grumbullim pikësh mbi 85/100% si dhe masterin e nivelit të dytë.
3. Kriteria të tjera të konkurimit, propozohen nga njësitë përkatëse bazë dhe miratohen nga dekani i fakultetit/drejtori i institutit dhe nga rektori i UPT.

Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës

4. Kandidatët konkurojnë në bazë të konkurseve publike duke zbatuar afatet përkatëse.
5. Procedurat për përzgjedhjen e kandidatit fitues janë:
 - Njësia bazë/kryesore paraqet kërkesën për plotësim të vendit vakant të punës, duke specifikuar kriteret që duhet të plotësojë kandidati/ja për këtë vend pune.
 - Kjo kërkesë i paraqitet Rektoratit të UPT
 - Rektorati UPT shpall në median e shkruar dhe/apo elektronike konkursin për këtë vend vakant pune, brenda një muaji.
 - Rektorati/Njësia kryesore afishon njoftimin përkatës në vende të dukshme.
 - Kandidatët kanë në dispozicion të paktën 1 (një) muaj, nga data e shpalljes së konkursit, për të paraqitur pranë Drejtorisë së Personelit në UPT dosjen për konkurim.
 - Rektorati bën publike datën e zhvillimit të konkursit.
 - Rektorati/Njësia kryesore shpall përbërjen e Komisionit të shqyrtimit të dosjeve të kandidatëve.
 - Vlerësimi i kandidatëve kryhet me kriterë të pikëzuar, të propozuara nga njësia bazë dhe të miratuara nga njësia kryesore.
 - E gjithë procedura është transparente.
 - Përzgjidhet ai kandidat që plotëson më mirë kërkesat e publikuara dhe i përgjigjet më mirë përshkrimit të vendit të punës.
 - Kandidatët jo fitues kanë në dispozicion një afat kohor prej një jave për të paraqitur tek Rektori apelimin e tyre.
 - Mënyra e organizimit të konkursit dhe e përzgjedhjes së kandidatit, përcaktohen në procedura të veçanta, të miratuara nga Rektori.
6. Rektori i UPT bën miratimin përfundimtar të kandidatit fitues për personel akademik dhe administrativ dhe vendos datën e fillimit të marrëdhënieve financiare dhe pagën mujore në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 53

Kontratat e punës

1. Marrëdhëniet juridike të punës midis UPT dhe personelit akademik trajtohen në përputhje me Nenin 51 të Ligjit Nr. 9741, date 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”.
2. Marrëdhëniet juridike të punës midis UPT dhe personelit ndihmës mësimor – shkencor dhe personelit administrativ trajtohen sipas Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë.
3. Detyrat dhe të drejtat për personelin ndihmës mësimor-shkencor dhe për personelin administrativ përcaktohen në rregulloren e brendshme të UPT.

Neni 54

Marrëdhëniet e punës

1. Personeli akademik i brendshëm me titullin “Akademik” shërben në detyrë deri në moshën 75 vjeç, me përjashtim të rastit kur me kërkesën e tij lirohet nga detyra.
2. Personeli akademik i brendshëm me titullin “Profesor” shërben në detyrë deri në moshën 68 vjeç, me përjashtim të rastit kur me kërkesën e tij lirohet nga detyra.
3. Për të gjithë punonjësit e tjerë zbatohet Ligji Nr. 8889, datë 25.04.2002, “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 7932, datë 17.5.1995; nr. 8286, datë 16.2.1998; nr. 8392, datë 2.9.1998; nr. 8575, datë 3.2.2000; nr. 8776, datë 26.4.2001 dhe nr. 8852, datë 27.12.2001.
4. Personelit akademik i ndërpriten marrëdhëniet e punës kur nuk përmbush detyrimet e përcaktuara në kontratë, kur shkel Statutin dhe rregulloren e UPT, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.
5. Ndërprerja e marrëdhënieve të punës bëhet me propozim të dekanit/drejtorit dhe vendim të rektorit të UPT.
6. Personeli akademik në UPT që kërkon të dypunësohet merr leje në UPT sipas një Rregulloreje të veçantë.

Detyrat dhe të drejtat e personelit akademik

Neni 55

Norma mësimore

1. Norma vjetore mësimore-shkencore për çdo kategori punonjësish akademikë, rastet e lejimit të një norme më të ulët, elementët përbërës të saj si dhe konvertimi i këtyre elementëve në një njësi të vetme të llogaritshme, përcaktohen në udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës.
2. Personelit akademik të brendshëm i njihet e drejta e pagesës së orëve të realizuara mbi normën vjetore. Tarifat e pagesës së kësaj ngarkese përcaktohen në aktet nënligjore të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës.
3. Çështje të tjera që kanë të bëjnë me kohën e punës dhe të pushimit zgjidhen në përputhje me legjislacionin e punës në fuqi dhe kontratave të nënshkruara sipas procedurave ligjore.

Neni 56

Titullari i lëndës

1. Titullarë të lëndëve janë kategoritë: a) profesorë dhe b) docentë dhe, në mungesë të tyre, edhe kategoria lektorë.

Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës

2. Titullari i lëndës harton të gjithë dokumentacionin e nevojshëm mësimor për zhvillimin e lëndës dhe mban përgjegjësi për realizimin e plotë të tij.
3. Titullari i lëndës caktohet nga përgjegjësi i departamentit, bazuar në përvojën dhe kontributin në zhvillimin e disiplinës përkatëse dhe miratohet nga Dekani. Titullari i lëndës drejton mbarëvajtjen e zhvillimit të lëndës nga vetë ai apo pedagogë të tjerë dhe raporton në departament për problemet që mund të dalin.
4. Titullari i lëndës raporton në departament, në përfundim të çdo semestri, për punën e bërë në realizimin e procesit mësimor.

Neni 57

Ora e mësimit

1. Ora e mësimit është e pacenueshme. Personeli akademik zhvillon orën e mësimit në kohën dhe auditorin e përcaktuar në orarin e shpallur të mësimeve, me disiplinë dhe cilësi, në përputhje me planin mësimor, programin mësimor dhe evidencat e ngarkesave mësimore të miratuara.
2. Personeli akademik u siguron studentëve informacionin e nevojshëm nëpërmjet leksioneve të shkruara, teksteve mësimore, literaturës, kasetave video, CD, DVD, etj.
3. Personeli akademik në orën e mësimit, duhet të plotësojë normat e etikës qytetare që lidhen me paraqitjen dhe sjelljen e tij dhe këto norma t'i kërkojë të plotësohen edhe nga studentët.
4. Personeli akademik mirëpret çdo vërejtje dhe sugjerim që mund të bëhet nga studentët dhe kolegët e tij për përmirësimin e zhvillimit të orës së mësimit.
5. Për zhvillimin e orëve laboratorike personeli akademik përkatës kujdeset për plotësimin e infrastrukturës përkatëse. Në përshtatje me natyrën e punës laboratorike ajo mund të zhvillohet edhe pandërprerje.
6. Për zhvillimin e praktikave mësimore personeli akademik përkatës përgatit dokumentacionin dhe materialet e nevojshme si programin e praktikës, ciklin e punëve praktike, kërkesat për relacionin e praktikës etj, të cilat i miraton në departament. Në përshtatje me natyrën e praktikave mësimore përgjegjësi i lëndës mund të marrë pjesë ose instrukton lektorët apo asistentët dhe kontrollon zhvillimin e saj.

Neni 58

Tërheqja nga funksionet

Personeli akademik i zgjedhur ose i emëruar në funksione të ndryshme brenda institucionit ka të drejtë të heqë dorë nga ato, por për këtë duhet të njoftojë organet eprore përkatëse, jo më pak se 2 javë përpara

Neni 59

Viti akademik sabbatik

1. Personeli akademik me tituj në UPT ka të drejtë që çdo 7 vjet, për periudha kohe deri në një vit, të punojë për përparimin e tij akademik.
2. Gjatë kësaj periudhe, personelit akademik nuk i ngarkohet detyrë mësimdhënieje. Personeli akademik mund të ndjekë gjatë këtij viti edhe kurse specializimi deri tremujore jashtë UPT.
3. Kandidati paraqet në Departament programin e tij të përparimit akademik gjatë vitit akademik sabbatik dhe kohën e kryerjes së këtij kualifikimi
4. Departamenti dhe pas tij njësia kryesore jep/ose jo miratimin për kryerjen e këtij viti akademik sabbatik.
5. Për çdo semestër kandidati duhet të raportojë për ecurinë e përparimit të tij akademik. Në përfundim të vitit akademik sabbatik, punonjësi akademik paraqet në Departament raportin përfundimtar të aktivitetit të kryer.

Neni 60

E drejta e botimit dhe e pjesëmarrjes në aktivitete shkencore

- Personeli akademik paraqet në departamentin përkatës, planin e botimeve për tekste, artikuj, monografi, planin e pjesëmarrjes në aktivitete shkencore, brenda dhe jashtë vendit.
- Për realizimin e këtyre botimeve personeli akademik kërkon mbështetje financiare nga UPT.

Neni 61

E drejta e asistencës

Personeli akademik ka të drejtë të kërkojë nga UPT asistencë në plotësimin e nevojave të tij jetike për sëmundje, fatkeqësi të skajshme etj., në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU 6

STUDENTI

Neni 62

Një person fiton statusin e studentit me regjistrimin në UPT dhe e humbet me marrjen e diplomës ose certifikatës përkatëse si edhe në raste të ndryshme të çregjistrimit të tij. Rastet e çregjistrimit përcaktohen në rregulloren e UPT.

Neni 63

Të drejtat

Brenda UPT, studentët kanë të drejtë:

1. Të përfaqësohen në Këshillat e fakulteteve, Këshillin e Administrimit dhe Senatin Akademik.
2. Të përfitojnë bursë studimi kur plotësojnë kushtet e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave si dhe shpërblime të veçanta që administrohen nga UPT.
3. Të shprehin opinionet e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të UPT.
4. Të ndjekin leksione, seminare/ushtrime dhe të gjitha veprimtaritë e tjera mësimore shkencore, të organizuara në përputhje me statusin e tyre.
5. Të përdorin mjedise në biblioteka, salla kompjuterash dhe shërbime të tjera që ofrohen për studentët nga UPT.
6. Të organizohen në shoqata studentore që nuk kryejnë veprimtari politike dhe ekonomike duke ju përmbajtur përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore përkatëse.
7. Të pajisen me Kartën e Studentit, që është dokument unik, me anë të së cilës studentët përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara. Kriteret dhe procedurat për përgatitjen dhe lëshimin e kartës së studentit përcaktohen nga MASH. Kategoritë e shërbimeve, që ofrojnë entet shtetërore bëhet me Vendim të Këshillit të Ministrave dhe me marrëveshje me organizma që kanë objekt të tyre interesat studentorë dhe me persona juridikë privatë që ofrojnë shërbime të ndryshme.

Neni 64

Detyrimet

Studentët janë të detyruar:

1. Të zbatojnë rregullat e përshkruara në Rregulloren e UPT
2. T'u kushtojnë vëmendje studimeve dhe të marrin pjesë në veprimtaritë akademike.
3. Të paguajnë tarifat e shkollimeve dhe të shërbimeve që u ofron UPT.

4. Të respektojnë kodin e etikës, të përcaktuar në rregulloren e etikes akademike te UPT.
5. Të tregojnë vëmendjen e duhur ndaj të drejtave të personelit dhe të studentëve të tjerë.

UPT nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e detyrimeve.

Neni 65

Këshillat e studentëve

1. Në UPT, studentët organizohen nëpër Këshillat e Studentëve, të cilat janë organizime të pavarura, që nuk zhvillojnë aktivitete politike dhe ekonomike. Këto këshilla promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të UPT, në strukturat mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve.
2. Këshillat e studentëve zgjidhen çdo vit nga votat e studentëve dhe mbështeten në legjislacionin në fuqi. Brenda Universitetit Politeknik, ato organizohen në nivel fakulteti dhe në nivel universiteti.
3. Këshillat e Studentëve nuk kanë të drejtë të organizohen me struktura të tjera politike e jopolitike, jashtë UPT. Modalitetet dhe procedurat për krijimin, organizimin dhe funksionimin e tyre përcaktohen në rregulloret e brendshme, të cilat hartohen në përputhje me këtë Statut dhe Ligjin Nr. 9741, dt 21.05.2007, i ndryshuar, mbështetur edhe në propozimet e paraqitura nga studentët.
4. Këshillat e studentëve shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të UPT, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive, etj.
5. UPT mbështet Këshillat e studentëve dhe financon veprimtari të tyre.

KREU 7

ORGANIZIMI I STUDIMEVE DHE TITUJT

Neni 66

Format e studimeve në UPT

1. Format e studimeve në UPT janë:

- a) studime me kohë të plotë;
- b) studime me kohë të pjesshme;
- c) studime në distancë.

Programe studimi me kohë të plotë ofrohen për të gjitha ciklet e studimeve. Në UPT, programe studimi me kohë të pjesshme dhe në distancë mund të ofrohen vetëm për ciklin e tretë, për Master të Nivelit të Parë dhe Master të Nivelit të Dytë.

2. Realizimi i secilës nga format e mësipërme të studimit bëhet, sipas propozimit të UPT-së, me miratim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 9741, datë 21.5.2007 dhe akteve nënligjore përkatëse në fuqi.

Neni 67

Programet e studimeve universitare

1. UPT ofron programe të akredituara të studimeve universitare, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS). Sasia mesatare e krediteve për një vit akademik është 60 kredite.

Një krediti i korrespondojnë 25 orë mësimore pune për studentin. Gjatë një viti, orët për punë të pavarur të studentit zënë jo më pak se gjysmën e fondit të përgjithshëm prej 1500 orësh mësimore punë të tij, që përfshijnë orët në auditor dhe për punë të pavarur.

2. Programet e studimeve universitare hartohen nga fakultetet dhe miratohen në Senatin akademik të UPT-së. Ato hartohen në përputhje me kërkesat e neneve 27, 28, 29 të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 9741, dt. 21.05.2007 dhe udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Programet e studimeve shpallen publikisht para fillimit të aplikimeve për pranimet në UPT.

3. Çdo lëndë apo modul ka përmbajtjen e saj/tij në përputhje me programet e studimeve të miratuara. Programet e lëndëve hartohen, sipas kritereve dhe formatit të miratuar nga Senati i UPT-së, prej anëtarëve të personelit akademik që janë titullarë/lektorë të lëndës. Programet mësimore konsultohen në grupin mësimor-kërkimor përkatës të Departamentit dhe miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit dhe Dekani i Fakultetit.

Neni 68

Viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies

1. Studimet universitare në UPT zhvillohen me bazë vitin akademik. Data e fillimit të vitit akademik shpallet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.
2. Viti akademik organizohet në dy semestra. Çdo semestër ka të paktën 14 javë mësim.
3. Çdo javë ka të paktën 20 orë mësimi leksione, seminare e laboratorë, struktura e të cilave pasqyrohet në programet e studimeve përkatëse.

Neni 69

Programet e studimit dhe titujt e diplomave në UPT

1. Programet e studimeve universitare në UPT organizohen në tre cikle të njëpasnjëshme: cikli i parë, cikli i dytë dhe cikli i tretë. Për degën e Arkitekturës cikli i parë i studimeve organizohet me periudhë studimesh 4 vjet.
2. Struktura e studimeve në cikle të ndryshëm studimi dhe titujt e diplomave të fituara me përfundimin e tyre janë në përputhje me përcaktimet përkatëse në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 9741, dt. 21.05.2007 si dhe aktet nënligjore në fuqi.
3. Për çdo cikël studimi, në programet përkatëse të studimeve përcaktohen edhe objektivat e synuara për formimin profesional të të diplomuarve. Objektivat formuese përcaktuese, të përgjithshme apo specifike, mbajnë parasysh kërkesat për nivele cilësore bashkëkohore dhe hartohen në bashkëpunim me përfaqësues të tregut të punës dhe profesioneve në nivel kombëtar.
4. Në UPT, me përfundimin e studimeve të cikleve përkatëse lëshohen diplomatat:
 - a) "Diplomë e nivelit të parë" (DNP)
 - b) "Diplomë e nivelit të dytë" (DND)
 - c) "Diplomë e integruar e nivelit të dytë" (DIND)
 - d) "Diplomë për gradën shkencore "Doktor" (Dr).

Krahas këtyre diplomave në përfundim të programeve të studimeve Master, jepet diplomë Master i Nivelit të Parë (MNP) dhe Master i Nivelit të Dytë (MND).

Kohëzgjatja normale e programeve të ciklit të parë me kohë të plotë është tre vite dhe për të fituar një diplomë DNP studenti duhet të ketë grumbulluar 180 kredite.

Kohëzgjatja normale e programeve të ciklit të dytë me kohë të plotë është dy vite të tjera pas përfundimit të një programi studimi të ciklit të parë dhe për të fituar një diplomë DND studenti duhet të ketë grumbulluar 120 kredite.

Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë është së paku pesë vite dhe për të fituar një diplomë të integruar DIND studenti duhet të ketë grumbulluar së paku 300 kredite.

Për të fituar një diplomë Master MNP studenti duhet të ketë grumbulluar 60 kredite dhe zgjatja e tyre normale është një vit.

Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës

Për diplomën e Arkitekturës kohëzgjatja normale e studimeve në ciklin e parë është 4 vjet (240 ECTS).

Për të fituar një diplomë Master MND studenti duhet të ketë grumbulluar së paku 60 kredite dhe zgjatja e tyre normale është një vit.

Programet e studimeve të ciklit të tretë zgjasin të paktën tre vjet dhe përfshijnë edhe 60 ECTS studime të organizuara.

5. Emërtimet e specialiteteve që vendosen në diplomat e fituara në përfundim të ciklit të parë dhe ciklit të dytë të studimeve në Fakultete të ndryshme të UPT-së miratohen në Senat, mbi bazën e propozimeve të Këshillave të fakulteteve përkatëse.

6. UPT lëshon diploma për gradën shkencore Doktor (Dr), në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë, Nr. 9741, dt. 21.05.2007 si dhe aktet nënligjore në fuqi.

Programet e studimit të doktoratës kanë në bazë kërkim shkencor dhe veprimtari krijuese të pavarur.

7. Format i diplomave që lëshohen nga UPT miratohet nga Senati i tij.

Neni 70

Pranimet në ciklin e parë, ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve

1. Pranimi i studentëve në cikle të ndryshme në UPT bëhet në përputhje me përcaktimet përkatëse Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 9741, dt. 21.05.2007 si dhe akteve nënligjore në fuqi.

2. UPT mund të përcaktojë kritere të veçanta për përzgjedhjet e kandidatëve për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve në fakultete të ndryshme të tij. Këto kritere i dërgohen Ministrisë së Arsimit dhe Shkences.

3. Sipas propozimeve të Këshillave të Fakulteteve, me miratim të Senatit, UPT përcakton kriteret e përzgjedhjes për ciklin e dytë dhe ciklin e tretë të studimeve.

4. Kriteret e pranimit të studentëve bëhen publike.

Neni 71

Transferimet

1. UPT ofron mundësi për transferimin e studentëve midis programeve të të njëjtit cikël në fakultete të ndryshme brenda UPT-së. Mundësohen gjithashtu transferime nga programe të sistemeve të mëparshme të studimeve universitare në UPT në programe të ciklit të parë në UPT.

2. UPT ofron mundësi për transferimin e studentëve nga institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit në UPT.

3. Kriteret dhe procedurat e transferimeve përcaktohen në Rregulloren e UPT.

Neni 72

Ndjekja e një programi të dytë studimi

1. Individët që kanë përfunduar një program studimi, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi pranë UPT-së, sipas kërkesave dhe përcaktimeve përkatëse të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 9741, dt. 21.05.2007 si dhe akteve nënligjore në fuqi.

2. Në çdo fakultet, komisioni përkatës për njohjen dhe ekuivalentimin e krediteve përcakton lëndët dhe detyrimet që duhet të realizojë kandidati që kërkon ndjekjen e një programi të dytë të studimeve. Vendimin për ndjekjen e një programi të dytë studimi e merr Rektorati.

Neni 73

Programet e studimeve të formimit të vazhduar

1. UPT ofron programe të studimeve të formimit të vazhduar, në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 9741, dt. 21.05.2007 dhe aktet nënligjore në fuqi.

2. Programet e studimeve të formimit të vazhduar, kohëzgjatja, organizimi i mësimdhënies dhe kreditet e tyre propozohen dhe hartohen në departamentet që mbulojnë këto programe studimi. Programet miratohen nga Këshilli i Fakultetit dhe nga Senati i UPT-së.

3. Në përfundim të këtyre programeve, individeve të kualifikuar u lëshohet Çertifikata përkatëse, firmosur nga Dekani Fakultetit dhe nga Rektori i UPT-së. Për të fituar një Çertifikatë në përfundim të një programi formimi të vazhduar, studenti duhet të ketë grumbulluar një numër të nevojshëm kreditesh. Këto përcaktohen nga Senati i UPT, mbi bazën e propozimit të Këshillit të Fakultetit.

KREU 8

SIGURIMI I CILËSISË

Neni 74

Organizimi strukturor

1. UPT është përgjegjës për sigurimin e brendshëm të cilësisë në të gjitha njësitë përbërëse organizative. Për këtë, funksionon rrjeti i cilësisë me përgjegjësinë e ngritjes, implementimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në UPT, mbështetur në standardet shtetërore të cilësisë si dhe standardet dhe udhëzimet europiane për Sigurimin e Cilësisë në HEAL.
2. Rrjeti i Cilësisë përbëhet nga Qendra e Cilësisë, e ngritur pranë rektoratit të UPT, dhe përfaqësues të cilësisë në çdo njësi kryesore.
3. Rrjeti i cilësisë harton rregulloren e funksionimit të tij si dhe gjithë dokumentacionin e nevojshëm për menaxhimin e sistemit të cilësisë në njësitë përbërëse.
4. UPT përcakton në buxhetin e institucionit fondet e nevojshme për ngritjen, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemit të cilësisë
5. Senati i UPT miraton të gjithë dokumentacionin për sistemin e cilësisë.

Neni 75

Vlerësimi i brendshëm i Cilësisë

1. Qendra e cilësisë planifikon organizimin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë të programeve të studimit dhe të vlerësimit të brendshëm institucional. Për të realizuar këtë ngrihet grupi i vlerësimit të brendshëm, ku merr pjesë edhe një përfaqësues nga organizimet studentore. Në rast nevoje, ftohet një përfaqësues ekspert i jashtëm. Grupi i vlerësimit të brendshëm ngrihet nga njësia përkatëse. Ai ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Vlerësimi i brendshëm realizohet në përputhje me udhëzimet përkatëse të AAAL. Konkluzionet e vlerësimit të brendshëm mbështeten në analizën statistikore të të dhënave, në konstatimet e nxjerra nga regjistrat, në sondazhet, pyetorët dhe intervistat e organizuar me stafin akademik, stafin joakademik dhe studentët. Drejtuesit e njësive të vlerësuara publikojnë rezultatet e vlerësimit të kryer.
2. Vlerësimi i brendshëm i programeve të studimit apo institucional organizohet si rregull një herë në 5 vjet. Nëse është e nevojshme, njësia mund të organizojë vlerësime të pjesshme edhe më shpesh. Mënyra e organizimit të vlerësimit të brendshëm, aktivitetet që kryhen, përgjegjësitë dhe mënyra e paraqitjes së rezultateve përcaktohen në rregulloret dhe procedurat përkatëse.

Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës

3. Qendra e cilësisë në bashkëpunim me AAAL organizon trajnim të anëtarëve të grupit të vlerësimit. Për anëtarët e grupit të vlerësimit njësia merr masat e sigurimit të kushteve të përshtatëshme për realizimin e kësaj detyre.
4. Njësia ka përgjegjësinë e sigurimit të burimeve të nevojshme financiare për mbulimin e gjithë aktiviteteve të procesit të vlerësimit të brendshëm.
5. Qendra e cilësisë mban lidhje të vazhdueshme me Agjensinë publike të Akreditimit të Arsimit të lartë për realizimin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë dhe vlerësimin e jashtëm.

KREU 9

KËRKIMI SHKENCOR DHE SHËRBIMET

Neni 76

Kërkimi shkencor dhe zhvillimi në UPT

1. UPT kryen kërkim shkencor bazë dhe të aplikuar, studime dhe projekte për zhvillim dhe veprimtari të tjera krijuese, në mënyrën e përcaktuar në këtë statut dhe sipas objektivave specifike të tij.
2. Veprimtaria e kërkimit dhe zhvillimit që kryhet në UPT, synon dhe në rritjen e cilësisë së arsimimit nëpërmjet integritit të kërkimit shkencor me mësimdhënien. Ajo u jep studentëve aftësi metodologjike për kërkim, jep mundësi të vazhdueshme në plotësimin e disiplinave mësimore me njohuri shkencore dhe praktike të avancuara, nëpërmjet përfshirjes në programet mësimore, të metodave, metodikave, teknikave e teknologjive të reja e të konkluzioneve me karakter teorik e praktik të kërkimit shkencor, përmirëson kualifikimin e personelit akademik dhe krijon mjete materiale për zhvillimin dhe punën në UPT.
3. Veprimtaritë kërkimore përcaktohen në rregulloret e secilës nga njësitë kryesore, bazë e ndihmëse të UPT-së, dhe kryhen mbi bazën e planeve, programeve dhe projekteve të miratuara, sipas procedurave të përcaktuara në këtë statut dhe në rregulloret e vetë njësive.
4. Personeli akademik është i lirë të kryejë veprimtari kërkimi e zhvillimi për të tretë, por me kusht:
 - a. plotësimin e detyrimeve ndaj Universitetit Politeknik, sipas kontratës së punës;
 - b. plotësimin e detyrimeve të njësisë përbërëse të Universitetit Politeknik, bazë dhe kryesore, për kërkim shkencor, sipas pikës 1 të këtij neni.

Neni 77

Veprimtaritë kërkimore në UPT

1. Kërkimi shkencor, bazë dhe i aplikuar, me interes të gjerë publik, është veprimtari që ndërmerret për të përmbushur misionin e njësive për kërkim shkencor, sipas standarteve bashkëkohore. Kërkimi shkencor bazë nënkupton studime plotësuese dhe saktësime të mëtejshme për probleme ende të pazgjidhura në fushat e veprimtarisë së njësive kryesore. Këto studime duhet të synojnë ritmet e zhvillimit teorik bashkëkohor, në koherencë me arritjet në fushat përkatëse, brenda dhe jashtë vendit. Kërkimi shkencor shoqërohet me rinovime teknologjike në fushën analitike, të përpunimit të informacionit etj., për të garantuar cilësinë dhe besueshmërinë e tyre. Veprimtaria kërkimore shkencore e

- aplikative është pjesë integrale e projekt buxhetit të UPT-së për çdo vit pasardhës.
2. Temat dhe afatet e kërkimit, drejtimet dhe vëllimi i punëve përcaktohen nga UPT dhe njësitë përbërëse të tij. Këto përcaktohen mbështetur në nevojat e zhvillimit të vendit, rëndësinë e kërkimit për arsimimin e studentëve, programet e bashkëpunimit shkencor, aftësimin e personelit akademik, si dhe burimet financiare në dispozicion.
 3. Forma kryesore e realizimit të veprimtarisë kërkimore është projekti. Punonjësit kërkimorë shkencorë të profileve të ndryshme, brenda dhe jashtë departamenteve të njësive kryesore janë të lirë të grupohen e të përpilojnë projekte në përputhje me fushat e kërkimit shkencor dhe programet publike të zhvillimit të vendit apo sektorëve të veçantë, të ndjekin procedurat e caktuara për shqyrtimin e miratimit e projekteve dhe, pas miratimit, të vihen në dispozicion të zbatimit të tyre në kohë e me cilësinë e kërkuar.
 4. Njësitë kryesore të UPT hartojnë planin afat – mesëm disavjeçar të zhvillimit të tyre. Mbështetur në planin e zhvillimit hartohen programet vjetore të veprimtarisë së tyre, duke caktuar e vendosur raporte të drejta ndërmjet mësimdhënies e kërkimit shkencor në përputhje me misionin që ato kanë. Plani i zhvillimit paraqitet në rektorat dhe miratohet në Senatin Akademik.
 5. UPT kryen shërbime për të tretë si ekspertiza, analiza, këshillime, monitorime, shërbime informacioni etj. Këto veprimtari kryhen me financime të palëve të interesuara. Të ardhurat nga këto veprimtari shkojnë tërësisht në favor të UPT dhe përdoren në masën 100% nga njësia kryesore që e ka kryer atë shërbim.
 6. Tarifat e studimeve si dhe të shërbimeve për të tretë propozohen nga njësia bazë dhe miratohen nga Këshilli i njësisë kryesore.
 7. Masa e shpërblimit të personelit pjesëmarrës në këtë veprimtari, përcaktohet në përputhje me kontributin e secilit pjesëmarrës dhe miratohet nga Këshilli i Njësisë kryesore, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
 8. Brenda tremujorit të parë të çdo viti, njësitë kryesore të UPT dorëzojnë në degën shkencore një raport vjetor për veprimtarinë kërkimore-shkencore, të vitit paraardhës. Të gjitha të dhënat e kërkimit shkencor mblidhen si shënime statistikore të standardizuara dhe ruhen në një bazë qendrore të të dhënave të mundësuar nga Rektorati.

Neni 78

Planifikimi dhe vlerësimi i veprimtarive kërkimore

1-Veprimtaritë kërkimore bëhen mbi bazën e planit të zhvillimit strategjik të UPT, të programeve dhe projekteve të miratuara, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” Nr. 9741, date 21.05.2007, i ndryshuar, si dhe akte të tjera ligjore e nënligjore.

2-Kërkesa për financimin e programit vjetor të kërkimit shkencor bazë dhe të

Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës

aplikuar nga buxheti i shtetit, bëhet nga njësitë kryesore në përputhje me aktet nënligjore të Ministrisë së Financave për hartimin e buxhetit për vitin pasardhës, paraqitet në rektorat dhe në MASH.

3-Performanca e punës kërkimore e të gjitha llojeve e niveleve vlerësohet nga këshillat e njësive kryesore të UPT dhe nga Senati Akademik.

4-Programet e studimeve të ciklit të tretë dhe, në masë më të vogël, programet e studimeve të ciklit të dytë, konsiderohen punë kërkimore dhe i nënshtrohen planifikimit.

5-Brenda muajit tetor të çdo viti, njësitë kryesore të UPT-së, dorëzojnë në Degën Shkencore një raport për planifikimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore për vitin pasardhës.

KREU 10

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 79

1. Studentët e regjistruar në një program studimi, para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, do të vazhdojnë studimet e tyre me të njëjtin program studimi për kohëzgjatjen normale të tij.
2. Për studentët që nuk arrijnë të përfundojnë studimet në periudhën normale të studimeve, afati i fundit i përfundimit të tyre është viti akademik 2009 – 2010. Pas këtij afati ata humbin të drejtën e pajisjes me diplomë sipas programit të studimit që janë regjistruar. Ata mund të pajisen me diplomë të Nivelit të parë (DNP) sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren e UPT.
3. Studentët e regjistruar në studime pasuniversitare (Sh.P.U apo në Doktoratë) para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, do të vazhdojnë studimet deri në diplomimin e tyre, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.
4. Diplomat e fituara në studimet në kuadër të “Shkollës pasuniversitare të studimeve të thelluara” janë ekuivalente me diplomat “Master i Nivelit të Dytë”.

Neni 80

Personeli akademik i punësuar në UPT, i cili nuk ka shkallën e kërkuar të kualifikimit sipas vendit të punës, duhet që brenda pesë vjetëve nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të kryejë kualifikimet e kërkuara ose të largohet nga vendi i punës. UPT krijon kushtet dhe mundësitë për kualifikimet e nevojshme.

Neni 81

1. Në përputhje me Ligjin “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” Nr. 9741, datë 21.05.2007, i ndryshuar, dhe me këtë statut, Njësitë kryesore dhe njësitë bazë, hartojnë rregulloret e tyre të brendshme dhe rregullore të tjera.
2. Rregulloret e brendshme të njësive kryesore të UPT hartohen nga këshillat e këtyre njësive dhe miratohen nga rektori i universitetit, ndërsa rregulloret e brendshme të njësive bazë hartohen prej këtyre njësive dhe miratohen nga dekani i fakultetit /drejtori i institutit.

Neni 82

- 1- Në zbatim të këtij Statuti hartohen, brenda vitit 2008, Rregulloret e mëposhtme:
 - Rregullorja e UPT
 - Rregullorja e funksionimit të Senatit
 - Rregullorja e Rektoratit të UPT
 - Rregullorja e funksionimit të Këshillit të Administrimit
 - Rregullorja e funksionimit të Këshillit të Etikës Akademike
 - Rregullorja e brendshme për administrimin, financat dhe kontabilitetin
 - Rregulloret e njësisve kryesore
 - Rregullorja e Këshillit të profesorëve
 - Rregullorja për sigurimin e sistemit të cilësisë
2. Brenda vitit 2008 të riformulohet Stema e UPT, përmes një konkursi publik.
3. Brenda vitit 2011 të hartohet Rregullorja e zgjedhjeve në UPT.

Neni 83

1. Universiteti Politeknik i Tiranës ka vulën e vet zyrtare, sipas modelit të miratuar nga Këshilli i Ministrave.
2. Njësitë kryesore të UPT kanë vulën e tyre, sipas modelit të miratuar nga Këshilli i Ministrave.
3. UPT ka faqen e tij të internetit me adresë www.upt.al, e cila administrohet nga UPT.

(Miratuar nga Senati, dt. 25.06.2008)

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. Jorgaq KAÇANI